P.nr.131/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Shehu, punëtore e kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit B. K. nga Rahoveci, rr. "A. B.", p.n., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8, lidhur me par. 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1070/2016 të datës 11.04.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të Shtetit Armend Zenelaj dhe të akuzuarit, më datë 18.12.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari,

B. K., nga i ati B. dhe e ëma L., e gjinisë Z., i lindur më dt. ..., në Rahovec, ku edhe tani jeton, rr. "A. B.", p.n., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me dt. 18.07.2017, rreth orës 13:00 minuta, në rrugën "A. B.", p.n., në Rahovec, saktësisht në shtëpinë e tij, duke vepruar në kundërshtim me nenin 54 paragrafi 1, lidhur me nenin 352 të Ligjit mbi sigurimin e komunikacionit rrugor të Kosovës, ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e tij të markës "VW Golf", me targa të regjistrimit ...-...-BS, ngjyrë e zezë, i pandehuri me të dalur rikferc nga shtëpia e tij në mënyrë të pasigurt duke mos e shikuar mirë rrugën prapa në retrovizorët anësor, ku si pasojë e kësaj pakujdesie, me pjesën e pasme ballore të automjetit të tij e godet të dëmtuarën H., me ç'rast dëmtime të rënda trupore merr e dëmtuara, sipas akt ekspertimit mjeko-ligjor të Dr.N. U., të dt. 21.03.2017.

-Këso dore ka kryer vepër penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8, lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 41, 49, 50, 51, 73, 74 dhe 378 par. 8, lidhur me par. 6 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

DENIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin B. K. e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej dy (2) vjet**,** nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara H. (Sh.) V., nga Rahoveci, rr. "V. F.", p.n., udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20,00 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 40,88 euro, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 30,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzën, PP.nr.1070/2016 të datës 11.04.2017, kundër të akuzuarit B. K., nga Rahoveci, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8, lidhur me par. 6 të KPRK-së,

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.12.2018, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Armend Zenelaj dhe i akuzuari B. K., ndërsa nuk ka qenë prezentë e dëmtuara për të cilën gjykata nuk ka provë se është ftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i cili ka qëndruar në tërësi pranë saj. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, si dhe e ka njoftuar lidhur me efektet e pranimit të fajësisë. I akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndihet fajtor dhe ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet edhe në provat dhe faktet që i bashkangjiten aktakuzës, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet në bazë të ligjit, po ashtu i njëjti të obligohet edhe në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Andaj nga të lartcekurat, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 248 par. 4 të KPPK-së, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës fillestare është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ka proceduar administrimin e provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8, lidhur me par. 6 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza e të cilat janë: Akt ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.N. U., të dt. 21.03.2017, përkitazi me natyrën, karakterin dhe shkallën e lëndimeve trupore të pësuara në aksident për të dëmtuarën H. (Sh.) V.; raporti i ekspertit të komunikacionit Inxh.Y. K., i dt. 02.09.2016, dhe mendimi i dhënë në të përkitazi me lëshimet dhe parregullsitë teknike gjatë drejtimit të automjeteve nga ana e të pandehurit, si dhe shkresat tjera në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kusht, me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.1 dhe 2.6, lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.131/2017, me datë 18.12.2018

Sekr. juridike,
Shemsije Shehu

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.